

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



NDËMJET

DHE

**YOUTH ARE THE
REAL LEADERS**

KOLEGJI BIZNESI

Youth Are the Real Leaders dhe Kolegji Biznesi -Prishtinë. (referuar si Palë)

Bien dakord për nënshkrimin e këtij memorandumi bashkëpunimi me qëllim krijimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të shërbimeve profesionale për të rinjtë, zgjerimin e mundësive për projekte të përbashkëta të ndihmës reciproke dhe inkurajimin e nismave me qëllim ngritjen profesionale të të rinjve.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e bashkëpunimit të ndërsjellët për shkëmbimin e praktikave dhe modeleve reciproke në kuadër të një fuqizimit të të rinjve dhe aftësimit profesional të tyre.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e promovimit të potencialit rinos përtej kufijve shtetërorë dhe me besimin tek vlerat më të mira profesionale dhe njerëzore.

Janë të lidhur me këtë memorandum bashkëpunimi me përbajtjen e mëposhtme:

Neni 1

Qëllimi

Palët do të janë pjesë e një bashkëpunimi me qëllim shkëmbimin e eksperiencës dhe praktikave më të mira nëpërmjet:

- a) Shkëmbimit të modeleve më efikase të strategjive për motivim e të rinxve;
- b) Hartimi me konsulencë të ndërsjellët i strategjive për fuqizimin e të rinxve;
- c) Trajnime profesionale dhe suport në hartimin e strategjive dhe programeve mbështetëse për stafin e të dy partnerëve;
- d) Përfshirje në aktivitetet e përbashkëta dhe të veçanta promovuese të profesionistëve të rinxë;
- e) Inkurajimi i çdo nisme tjeter që ka qëllim zhvillimin profesional të të rinxve;
- f) Mbajtja e punëtorive të rregullta për stafin dhe të rinjtë;
- g) Promovimi e punës vullnetare dhe qytetarisë aktive.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Me qëllim zbatimin me korrektësi të këtij memorandumi, Palët angazhohen:

- a) Të realizojnë projekte të përbashkëta me qëllim trajnimin e stafit dhe të rinxve në fusha të ndryshme me mentor, profesionist të fushës;
- b) Organizimin e seminareve, vizitave studimore, konferencave, “workshop”-eve në shkëmbimin e eksperiencave;
- c) Asistencë reciproke për çështje procedurale dhe materiale të lidhura drejtpërdrejt me avancimin e të rinxve dha avokim.

Neni 3

Forma të tjera bashkëpunimi

- a) Palët angazhohen të ofrojnë këshillime, asistencë, ofrimin e materialeve mbështetëse në përgjigje të zhvillimeve aktuale të politikave rimore dhe legjisacionit.
- b) Palët angazhohen të lobjnjë në favor të njëra-tjetrës për çështje të interesit të përbashkët apo respektiv të fuqizmit të të rinxve dhe zhvillimit profesional të tyre.

Neni 4

Ndryshimi i Memorandumit

Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me miratimin unanim të të dy palëve dhe kohëzgjatja e tij është në vullnetin e lirë të palëve, sipas vlerësimit të tyre diskrecional.

Neni 5

Hyrja në fuqi e Memorandumit

Memorandumi hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy Palët. Memorandumi mund të përfundojë në çdo kohë nëpërmjet njës njoftimi paraprak nga ana e çdo Pale.

Memorandumi mbahet në dy kopje origjinale për secilën prej palëve dhe në rast konfuziteti në interpretim do të prevalojë ai kuqtim që jep përfundimin më të favorshëm për palët.

Neni 6

Përfaqësimi i Palëve



Secila prej palëve do të përfaqësohet prej Drejtorit ekzekutiv ose sipas rastit prej përfaqësuesve të caktuar prej tyre.

Neni 7

Ky memorandum bashkëpunimi nënshkruhet në datën 10.12.2020 në Kosovë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit.

Për

Youth Are the Real Leaders


Drejtor ekzekutiv


Znj. Kosovare Sadiku

Për

Kolegji Biznesi



Z. Shyqeri Kabashi